“Do të vijojmë të mbështesim punën e Autoritetit, jo vetëm për platformën edukative, por edhe për misionin e gjerë të zbardhjes së së kaluarës dhe përkujtimit të viktimave të regjimit,” – u shpreh Manja duke shprehur se do të angazhohet për ecurinë e draft VKM që i hap rrugë procesit të rikuperimit të trupave të të zhdukurve.”- tha z. Manja.

## **LANÇOHET KLUBI I FILMIT “MËSOJMË NGA E KALUARA”**

Tiranë, 14 nëntor 2025

Me filmin “Toka jonë” nisi rrugëtimin Klubi i Filmit “Mësojmë nga e Kaluara” një bashkëpunim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF). Klubi i Filmit është një nismë e re edukimi dhe reflektimi mbi mënyrën se si kinemaja e periudhës komuniste iu nënshtrua censurës së regjimit dhe ndikoi në formësimin e kulturës politike, shoqërore duke shtrembuar perceptimin mbi të ashtuquajturat reforma të zbatuara në diktaturë dhe që vijojnë edhe sot e nxisin nostalgji të dëmshme.

Kryetarja e AIDSSH, Dr. Gentiana Sula, theksoi domosdoshmërinë e ndërtimit të mendimit kritik përmes filmave të prodhuar gjatë viteve ’44–’91, duke vënë në qendër konceptin e mendimit historik duke deklaruar “se nuk bëhet fjalë vetëm për fatin e një familjeje apo njollosjen e reputacionit të një individi, por për ngjarje me domethënie të lartë historike, ngjarje që patën ndikim afatgjatë gjatë dhe pas diktaturës.”



“Fakti që një diskutim i tillë mbi filma të komunizmit po ndodh vetëm pas 35 vitesh tregon se ende ka barriera institucionale, klishe dhe stereotipe që duhen adresuar. Filmat e asaj kohe nuk janë vetëm art – ata janë dokumente të një strategjie propagande, një forme të inxhinierisë shoqërore që ndikoi thellë në ndërgjegjen kolektive.”

Drejtorit të AQSHF, z. Eljan Tanini tha se: “Arkivi i Filmit ruan historinë tonë filmike, një trashëgimi e çmuar që na shërben për të mësuar. Filmat e së kaluarës mbartin vlera artistike dhe dëshmi të kohës, pavarësisht ngarkesës ideologjike që i shoqëroi. Me Klubin e Filmit të Autoritetit krijojmë një hapësirë ku filmi lidhet me dokumentin arkivor, duke i ndihmuar sidomos të rinjtë t’i lexojnë këto vepra me sy kritik dhe të informuar.”

“Toka jonë” përfaqëson një shembull tipik të mënyrës se si kinemaja u përdor për të legjitimuar politikën e kohës, duke ndërtuar narrativa të njëanshme që sot duhen lexuar përtej propagandës. Filmi është plot me të pavërteta dhe ne i japim kuptim historisë vetëm kur themi të vërtetën; në të kundërtën nëse nuk e themi atë bëjmë të njëjtën gjë si në diktaturë.” – u shpreh anëtari i AIDSSH, z. Gjergj Marku.



Në analizën e tij historike, studiuesi Xhafer Sadiku, nënvizoi se reforma agrare dhe kolektivizimi, të paraqitura si zhvillim ekonomik dhe social në realitet sollën vetëm goditjen e shtresave të ashtëquajtura të pasura, solli perndjekjen, izolimin shoqëror të tyre, internime, dënime dhe burgime. Sipas tij lufta e klasave në një shoqëri pa klasa siç propagandonte pushtetit totalitar është terrorizëm.

Studiuesja e artit, znj. Anxhela Çikopano, shtoi se drama “Toka Jonë” ishte një nga dramat më të vëna në skenën e realizimit socialist, e cila u ripërshtat shumë shpejt për nevojat ideologjike të pushtetit. Ajo u shkrua për të ndërtuar konfliktin ideologjik përmes artit, duke përdorur personazhet “negativë” si figura përfaqësuese të atyre që regjimi shpalli armiq, ç’ka tregon se filmi ishte një mekanizëm estetik i kontrollit të partisë mbi shoqërinë.”



Në prezantimin e tij, Dr. Edlir Orhani, solli gjetje të rëndësishme arkivore nga dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të cilat hedhin dritë mbi realitetin e familjes Syku, duke treguar kontrastin midis narrativës filmike dhe dokumenteve historike që dëshmojnë trajtimin e padrejtë të këtyre familjeve si dhe dënimet e padrejta me burgim.

Pasardhësi i familjes Syku, z. David Syku solli para të pranishmëve historinë e familjes se tyre ndër më të goditurat, e cila në kinemanë e kohës u portretizua përmes figurës së “Tuc Makut”. Ai rrëfeu se shpallja kulake u kthye në një damkë shumëvjeçare. 9 burra të familjes u burgosen, femijeve u mohua arsimiti, por ne fshat edhe pse kishin frikë doli shprehja “Mire Gjon Sykun e bete si ne, por ne a beheni dot si Gjoni”.



Në përmbyllje, shkrimtarja Rovena Rrozhani, e cila moderoi takimin riktheu pyetjen për të pranishmit pyetjen: Si duhet ta lexojë brezi i sotëm një film, kur dokumentet tregojnë një realitet të shtrembëruar nga kinemaja?

Pjesëmarrësit në debatin që shoqëroi aktivitetin thanë se filmi duhet parë si burim studimi, jo si dëshmi historike, ndërsa analizat arkivore dhe rrëfimet njerëzore ndihmojnë të dekonstruktohen modelet e stigmatizimit që kinemaja komuniste mbolli tek publiku i kohës dhe që, në mënyra të nëndërgjegjshme, vijnë edhe sot.



Klubi i Filmit synon të sjellë një lexim të ri, të balancuar dhe të bazuar në dokumente. Nisma është pjesë Platformës Arsimore “Mësojmë nga e Kaluara -me burime të hapura arsimore ‘44-‘91”, e cila u ofron mësuesve, nxënësve dhe studiuesve materiale arkivore të digjitalizuara, pasazhe filmike të përzgjedhura, dëshmi të mbijetuarve, module diskutimi të udhëhequra nga ekspertë të arsimit, historisë dhe artit. Qëllimi është të ndërtohet mendimi kritik dhe të kuptohet më qartë lidhja mes artit, propagandës dhe shtypjes së grupeve shoqërore.



Filmat shqiptarë të prodhuar gjatë periudhës komuniste nuk i shpëtonin asnjë detaji të censurës. Në ta, kategoritë e shpallura “armiqtë e klasës” paraqiteshin në mënyrë të njëtrajtshme: të pabesë, agjente huaj. Armiq të popullit.

Ky stereotip përfshinte: familjet e pasura dhe pronarët e tokës, tregtarët dhe zejtarët e pavarur, intelektualë të konsideruar “të dyshimtë”, njerëz me biografi “të keqe” që shpesh as nuk kishin kryer asnjë faj. Roli “negativ” në film, i interpretuar nga aktorë që sot i njohim për talentin e tyre, përkthehej në realitet në izolim, tallje publike, refuzim social dhe ndërprerje të prespektivës të jetës.

Kinemaja e ndikuar dhe nenpresion ushqente paragjykimet dhe i justifikonte politikat e regjimit. Kjo trashëgimi kulturore, e gdhendur në kujtesën kolektive për dekada, ende ka pasoja në mënyrën si shoqëria i percepton sot disa kategori sociale.

## **KRYETARJA E AIDSSH-S PËRKUJTON 81- VJETORIN E VIKTIMAVE TË GJENOCIDIT POLITIK**

Tiranë, 17 nëntor 2025

Me rastin e 81-vjetorit të 39 viktimitave të terrorit komunist në Tiranë, Kryetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Gentiana Sula, mbajti një fjalë në nderim të intelektualëve, klerikëve, juristëve dhe oficerëve të ekzekutuar në vitin 1944.

Aktiviteti, i organizuar nga Shoqata “Tirana” dhe familjarët e viktimitave, mbledhi përfaqësues të institucioneve të kujtesës, historianë, organizatat e të përndjekurve politikë si dhe personalitete nga Kosova. Ceremonia nisi me Himnin e Flamurit, pasuar nga referimi historik i studiuesit Uran Butka, dhe video-projeksioni “Viktimat e Terrorit Komunist në Tiranë”. Në vitin 2009 Presidenti i Republikës, Bamir Topi dekoroi viktimat me medaljen “Nderi i Kombit”.



“Unë jam Gentiana Mara Sula. U linda dhe u rrita në shtëpinë e Ymer Dërhemit, atje ku, natën e 28 tetorit 1944, dyert u hapën jo për të mirëpritur, por për të marrë plumbin pas shpine. Nga ajo derë doli për herë të fundit kolonel Akil Sakiqi, oficer i patëmetë i Ushtrisë Kombëtare, bashkë me Nazmi Uruçin dhe Fahri Dabullën, burra që dinin të vdisnin me fytyrë nga armiku, por që i vranë pabesisht. Vdekja e tyre nuk ishte e zakonshme, por prerje në besë, thikë pas shpine, vrasje e qytetërimit në mes të qytetit. Shumë vite më vonë, kur gjyshit tim ia morën gjithçka – shtëpinë, lirinë, emrin – dhe e zhdukën në burgjet pa kthim, familja ime gjeti strehë pikërisht në atë shtëpi të mallkuar dhe të shenjtë njëherësh. Fati deshi që në të njëjtën vatër, nga ku u shuan tre burra, nga dhjetëra të tjerë të asaj jave terrori (28 tetor–17 nëntor 1944), lindi një familje e re. Këtë histori ma tregoi i paharruari Osman Kaceli, bir i një martiri tjetër, falë të cilit punës sime iu shtua edhe një tjetër amanet.”- tha në fjalën e saj, kryetarja e AIDSSH, dr. Gentiana Sula e cila u shpreh se përulet para studiuesve si Uran Butka dhe tjetër të cilët ia dolën të zbardhin të vërtetën nëpërmjet hulumtimit të dosjeve dhe dokumenteve të arkivit

“Falë tyre e dimë sot se çfarë ishte vërtet ai nëntor: një gjenocid politik i planifikuar me lista, me data, me njësitë ndëshkimore, me urdhra që vinin nga lart dhe ekzekutoheshin në heshtje. Një vrasje sistematike e kreut të kombit, që të mos mbetet asnjë mendje e lirë.



E njëjta dorë që e mbyti Tiranën, e mbyti edhe Varshavën, Budapestin, Pragën, Bukureshtin, Sofjen, Beogradin. E njëjta metodë: premtim dorëzimi, fjalë nderi, pastaj plumbi në errësirë, trupi në përrua, varri pa krye. Në të njëjtat javë të 1944-ës dhe 1945-ës, nga Baltiku te Adriatiku, u shua një botë që besonte te liria pa zinxhirë. Dhe kudo, pas plumbit erdhi policia politike, që e mbajti plagën gjallë për gjysmë shekulli. Por para se të flas për terrorin, dua të përulem edhe një herë me respekt të thellë ndaj të gjithë partizanëve antifashistë që dhanë jetën për të dëbuar pushtuesin e huaj. Nderi dhe lavdia u takon atyre që luftuan me pushkë në dorë kundër pushtuesit të huaj, që ranë në male dhe në qytete, për një Shqipëri të lirë.

Dhimbja e familjeve tona nuk na verbon. Ne dimë të ndajmë trimërinë nga krimi, sakrificën nga terrori. Sepse pikërisht këtu qëndron një nga mësimet më të rënda të kësaj historie: Lufta kundër pushtuesit të huaj, sado e lavdishme, nuk mjafton për të sjellë liri për të gjithë. Mund të fitosh luftën dhe të humbësh paqen. Të çlirosh tokën dhe të robërosh shpirtin. Liria e vërtetë lind vetëm kur,



pas pushkës, vendoset ligji, nderi dhe barazia para drejtësisë – jo hakmarrja dhe lista e zezë. Tmerri nuk mbaroi në nëntor 1944.

Sigurimi i Shtetit u lind pikërisht atë natë, nga të njëjtat lista dhe nga të njëjtat duar. Çdo fëmijë i këtyre familjeve lindi me një kryq të padukshëm në ballë: “biografi e keqe”. Dhimbja nuk u varros; u trashëguar. Por sot mësojmë edhe një të vërtetë më të madhe, se çdo plumb dhe se çdo dosje: Sado që u përpoqën ta fshehin terrorin, sa do që u munduan t’i shajnë këta burra dhe gra, t’i quajnë «tradhtarë», «kolaboracionistë», «të klasës së vjetër», sa do që i hodhën në përrua pa varr dhe pa emër – këta njerëz nuk u harruan kurrë. Emrat e tyre i mbajtën gjallë nënat nën zë, i mbajtën gjallë fëmijët nëpër burgje, i mbajti gjallë zemra e kombit. Kurse ata që i vranë, dhe pasardhësit e tyre që ende mundohen ta justifikojnë, i mbuloi turpi – turp që nuk lahet as me njëqind vjet heshtje. Prandaj këto përkujtime nuk janë vetëm homazh, janë detyrë. Janë detyrë ndaj të vërtetës, ndaj fëmijëve që do të lindin nesër, ndaj Shqipërisë që të mos lejojë më kurrë ndarjen në “ne” dhe “ata”. Le të mos hapen më kurrë dyert për plumbin që vret pas shpine. Le të hapen vetëm për dritën.” – përfundoi fjalën e saj kryetarja e AIDSSH-s.



## KOMISIONI PËR NISMAT QYTETARE MBËSHTET KËRKESAT BUXHETORE TË AIDSSH PËR 2026

Tiranë, 17 nëntor 2025



Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale mbajti seancën dëgjimore me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) lidhur me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2026”.

Në këtë seancë, kryetari i Komisionit, z. Fatmir Xhafaj, dhe nënkryetari z. Ivi Kaso vlerësuan rëndësinë e rolit të AIDSSH në edukimin qytetar, ruajtjen e kujtesës historike dhe transparencën institucionale.

Kryetarja e AIDSSH, Dr. Gentiana Sula, prezantoi projektin strategjik “Mësojmë nga e Kaluara”, një platformë edukative e bazuar në dokumente arkivore autentike, e cila synon të edukojë mësuesit, nxënësit dhe studentët mbi periudhën totalitare 1944–1991.


AIDSSH një fond shtesë prej 12.6 milionë lekësh për zhvillimin e platformës e-learning, dixhitalizimin e e-akteve, pajisje për prodhim materiale audiovizuale, krijimin e një “box room” interaktiv dhe masa për eficiencë energjetike në godinë.

Komisioni mbështeti kërkesat dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm, duke theksuar rëndësinë e platformës edukative për të lidhur të kaluarën me të ardhmen përmes njohjes dhe reflektimit historik.

## **AIDSSH DHE ICMP NË PANAHOR PËR VENDVARRIMET E DYSHUARA TË TË DËNUARVE TË REPARTIT 309 BALLSH**

Ballsh, 18 nëntor 2025

Ekspertë të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me



ICMP-në, kanë nisur disa verifikime paraprake në terren të një vendvarrimi të dyshuar në fshatin Panahor, Njësia Administrative Aranitas, ku mendohet se prehen disa nga të dënuarit politikë që humbën jetën gjatë vuajtjes së dënimit në Repartin nr. 309 (360) Ballsh.

Ballshi mbetet një nga zonat më të ngarkuara me histori të shfrytëzimit çnjerëzor të të burgosurve politikë, të cilët u detyruan të punonin në ndërtimin e objekteve të rafinerisë së naftës. Shumë prej tyre kanë mbetur të zhdukur, pa një vendvarrim të njohur, duke ua mohuar familjarëve të drejtën për të vendosur një lule mbi emrin e të dashurve.

Për të çuar përpara procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur të periudhës komuniste, përfaqësues të AIDSSH, të drejtuar nga anëtari z. Gjergj Marku dhe ICMP zhvilluan sot një takim pranë Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, duke kërkuar nisjen e procedurave ligjore për zhvarrime në zonën e Panahorit.

Pas takimit, grupi i punës u zhvendos në vendngjarje për verifikimin e terrenit, ndërsa më pas u mbajt një takim informues në Bashkinë Ballsh me qëllim sigurimin e mbështetjes së plotë institucionale për hapat e mëtejshëm.

AIDSSH rikonfirmon angazhimin për t'u dhënë familjeve përgjigjet që kanë pritur për dekada dhe për të rikthyer me dinjitet çdo person të zhdukur te të afërmit e tij.

## **“DIALOG ME DAUT GUMENIN”: HISTORIA DHE LETËRSIA E REZISTENCËS DHE PËRBALLJA ME DOKUMENTET ARKIVORE**

Athinë, 5 dhjetor 2025

Në ambientet e Qendrës Kulturore të Bashkisë së Athinës, në amfiteatrin “Antonis Tritsis”, u organizua aktiviteti i përbashkët mes Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Athinë dhe Autoritetit për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, me titull “Dialog me Daut Gumenin”.

Aktiviteti kishte në qendër krijimtarinë letrare të autorit, veprimtarinë e tij si ish-diplomat dhe përndjekjen e gjatë që ai vuajti në burgjet komuniste, si she shenoi botimin në gjuhën greke të romanit të tij “Ditari i një Samarpunuesi”.



Fjalën e hapjes e mbajti ambasadorja e Republikës së Shqipërisë, znj. Luella Hajdaraga, e cila theksoi detyrimin moral të shoqërisë për të rikujtuar të shkuarën, në mënyrë që ajo të mos përsëritet. “Daut Gumeni nuk është vetëm një shkrimtar që rrëfen historinë e jetës. Ai është një ambasador i kujtesës, një dëshmitar i së vërtetës, një intelektual që e ktheu dhimbjen në rrëfim, heshtjen në fjalë, ndërsa fjalën e ktheu në akt shërimi.” Duke na rikujtuar se memoria nuk është luks dhe kujtesa është përgjegjësi, Ambasadorja Hajdaraga theksoi se “liria mbijeton tek njeriu që nuk dorëzohet dhe letërsia kthehet në dëshmi të dinjitetit njerëzor. Përpjekja për të prezantuar veprën e tij për publikun grek dhe për Trupin Diplomatik është një dëshmi e fuqisë së dialogut kulturor dhe e afërsisë mes shoqërive tona.”- veçoi znj. Hajdaraga.



Përfaqësuesi i Autoritetit të Dosjeve, Anëtari z. Altin Hoxha, vlerësoi punën e Daut Gumenit si ish-anëtar i Autoritetit dhe prezantoi për publikun dosjet që ish-Sigurimi i Shtetit kishte mbajtur për të. “Është një nder i veçantë të flasim sot për Daut Gumenin, si një nga zërat më të guximshëm që u përballën me mekanizmin represiv të diktaturës. Historitë e tilla na kujtojnë se dhuna shtetërore, megjithëse përpiket të kontrollojë mendimin dhe fjalën, nuk arrin kurrë të shuajë dinjitetin njerëzor. Autoriteti i Dosjeve mbetet i përkushtuar të dokumentojë me saktësi këtë të shkuar të dhimbshme, për t’i dhënë shoqërisë sonë njohjen e plotë për atë që ka ndodhur dhe për t’u bërë nder të gjithë atyre që u përballën me padrejtësinë.”- u shpreh z. Hoxha.



Në vijim, anëtari i Autoritetit, z. Skënder Vrioni, theksoi rëndësinë e veprës së Gumenit dhe ndikimin e saj në kujtesën kolektive: “Daut Gumeni, me romanin Ditari i një Sammarpunuesi, na ka dhënë një nga dëshmitë më të fuqishme të kujtesës sonë të plagosur. Përmes fjalës së tij të lirë, ai ringjall jo vetëm dhimbjen personale, por edhe dinjitetin e një brezi që nuk u përkul para dhunës së regjimit..”



“Shpesh më pyesin: ‘Si ia dole të mbijetosh?’. U them se njeriu i burgosur fizikisht mund të shkelet, të zhvishet nga gjithçka, por nëse arrin të mbash të gjallë një grimcë lirie brenda vetes, atëherë nuk të kanë mposhtur dot. Letërsia ime lindi pikërisht nga ajo grimcë – nga nevoja për të mos harruar, nga detyrimi për ta thënë të vërtetën, dhe nga një humor i brendshëm që, për fat të mirë, regjimi nuk arriti ta shkulë. Kur shkruajta ‘Ditari i një Sammarpunuesi’, nuk kisha qëllim të bëja një akt heroizmi. Kisha thjesht dëshirën të rrëfeja se ç’ndodh me njeriun kur i kërkohet të jetë dikush tjetër nga ai që është. Ai libër është, në thelb, një akt dëshmie për brezat që nuk e kanë jetuar atë kohë – dhe ndoshta edhe



një akt qetësimi për shpirtin tim. | - tha shkrimtari në këtë takim.” – tha për të pranishmit, shkrimtari Daut Gumeni.

Anëtari i Autoritetit z. Gjergj Marku dhe znj. Brunilda Çërraga, përfaqësuese e Drejtorisë së Hulumtimit Shkencor, i dorëzuan studiuesit të mirënjohur Dr. Stavro Dajo dokumente studimore nga arkivi, duke vlerësuar rëndësinë e kërkimeve shkencore dhe duke ftuar të pranishmit të aplikojnë për materiale arkivore.

Gjatë aktivitetit, Dr. Stavro Dajo vlerësoi punën e Autoritetit dhe solli aspekte të emigracionit politik në Greqi gjatë komunizmit, si edhe të ndërveprimit kulturor greko-shqiptar përmes përkthimeve dhe promovimit të letërsisë.

Takimi vijoi me prezantimin e krijimtarisë së Gumenit në gjuhën greke nga përkthyesi Kosta Jani, si dhe me transmetimin e një fragmenti nga dokumentari i regjizorit Ylli Pepo, i dedikuar jetës dhe veprimtarisë së tij.

Aktiviteti u përshëndet gjithashtu nga ish-ambasadori i Greqisë në Kosovë, Dimitris Moscopulos, dhe gazetari i televizionit grek TV ERT, Christos Nikolaidis, i cili vlerësoi punën e Autoritetit dhe u ndal në dokumentarin që pati realizuar së fundmi për televizionin SKAI TV.

Autoriteti pati mundësinë të rrisë kontaktet me anëtarë të shoqatave shqiptare që veprojnë në Athinë, duke i informuar për veprimtarinë e tij dhe mundësitë që ofron për aplikime, kërkime dhe dokumentacion. Në fund, u zhvillua një bashkëbisedim mes Daut Gumenit dhe publikut, i moderuar nga poeti Panajot Boli. Takimi u shoqërua me interpretime të veprës së autorit, recitime poetike dhe një fragment monodrame.

Takimi u mbyll me mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit dhe me vlerësimin se historia e Gumenit nuk është vetëm histori personale, por pjesë e kujtesës së mijëra shqiptarëve që përjetuan dhunën e diktaturës.

## **KLUBI I FILMIT “MËSOJMË NGA E KALUARA” ZBARKON NË LEZHË**

Lezhë, 10 dhjetor 2025

Pas lançimit të tij në Tiranë, Klubi i Filmit “Mësojmë nga e kaluara” u zhvillua në Lezhë. Në Pallatin e Kulturës së qytetit, ishin të pranishëm përfaqësues të pushtetit vendor, komunitetit, historianë të zonës dhe mësues e nxënës dhe media.

Në krye të aktivitetit znj. Brunilda Çërraga prezantoi misionin e AIDSSH-së si institucion në shërbim të informimit dhe edukimit qytetar. Ajo nënvizoi se Klubi i Filmit është një vijim i nismave edukative, krahas “Klubit të Librit”, dhe se qëllimi është të tregojmë se si ideologjia ndikonte përmes artit në krijimin e target-grupeve të diskriminuara. “Synimi është të vendosim në dritën e duhur figurat e personazheve të filmit ‘Toka Jonë’, duke i shqyrtuar përmes dokumenteve arkivore dhe dëshmive të familjes Syku.”

Më pas shkrimtarja Rovena Rrozhani prezantoi materialet e përgatitura me dokumente, video dhe fakte mbi historikun e filmit “Toka jonë” duke bërë një ballafaqim të historisë në dokumente dhe dëshmi me atë që është realizuar në film.



Duke ndërtuar kontekstin historik të kohës kur u përgatit filmi, historiani Paulin Zefi shpjegoi origjinën e termit “kulak” dhe përdorimin e tij politik. Ai solli gjithashtu panoramën e persekutimit të familjes Syku: “Familja Syku u godit si një familje e madhe dhe e pasur, e kategorizuar si kulake. Tokat iu konfiskuan, përfshirë sheshin qendror të Lezhës. Shtëpia u kthye në ‘shtëpi-burg’. Arrestime, izolime dhe mbi 100 vite dënime në total – dhe asnjë prej tyre nuk u lejua të arsimohej.”

Më pas, foli z. David Syku, pasardhës i familjes Syku të cilit i referohet personazhi kryesor i filmit, Tuç Maku. Ai falënderoi AIDSSH-në, AQSHF-në dhe Bashkinë Lezhë për organizimin dhe theksoi rëndësinë e sjelljes së kontekstit historik: “Filmi ka ndikuar në mënyrën si kjo shtresë shoqërore është parë si ‘e keqja e madhe’. Arsimi e prek shumë pak këtë periudhë – ndaj këto shpjegime janë të domosdoshme.” Më tej shtoi: “Shpesh shiheshim si ‘e keqja e shoqërisë’. Ideologjia de-formoi dramën. Familja jonë është rritur me idenë për të mos kultivuar mllef apo hakmarrje.”



Pas fjalës së tij Klubi i Filmit vijoi me pyetje-përgjigje dhe diskutime të shumta nga të pranishmit Z. Paulin Marku theksoi: “Familja Syku është ndër më të respektuarat, e papërzier politikisht. U goditën si familje malësore me traditë dhe besim katolik.”

Z. Martin Deda u shpreh: “Lezha ka qëndruar larg përbaljes me realitetin e diktaturës. Në vitet ‘60 njerëzit thoshin ‘Andrrat n’beze’ – një shprehje e ardhur nga ky film.”



Mësuesja e letërsisë Donika Haxhia solli një reflektim të rëndësishëm: “Gjuha gegë është stigmatizuar përmes personazheve negative dhe filmi nuk duhet transmetuar pa shpjegime të plota. E para duhet mësuar historia e vërtetë.”

Një tjetër pjesëmarrës shtoi: “Historia duhet t’u vijë brezave të rinj. Djemtë e Sykajve kanë lindur në demokraci, por filmi u ka lënë plagë – kjo nuk është rastësi.”

Diskutimet prekën edhe çështjen nëse filmat e realizmit socialist duhen shfaqur sot, dhe nëse patjetër duhet të shoqërohen me materiale shpjeguese për të ndriçuar të vërtetat e shtrembëruara nga ideologjia. Të pranishmit përshëndetën nismën e AIDSSH dhe AQSHF duke vlerësuar aktivitetin e Klubit të Filmit.



## POGRADEC, VIJON DIALOGU PËR FIGURAT E PASTRA, TË ZHDUKURIT DHE EDUKIMIN HISTORIK

Pogradec, 11 dhjetor 2025



Në bashkëpunim me Bashkinë e Pogradecit dhe me praninë e 14 përfaqësuesve të bashkive dhe këshillave bashkiakë të prefekturave Elbasan dhe Korçë, u zhvillua takimi i radhës i Dialogut të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me pushtetin vendor, në kuadër të nismës për verifikimin e kandidatëve për tituj vendorë të nderit dhe për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike; identifikimin dhe trajtimin e vendvarrimeve të viktimave të komunizmit; si dhe promovimin e kujtesës historike përmes muzeve, bibliotekave dhe institucioneve arsimore.

Nënkryetarja e Bashkisë së Pogradecit, znj. Entela Gusho, mirëpriti të pranishmit duke e vlerësuar takimin si një mundësi të rëndësishme për informim, bashkëpunim dhe ndërgjegjësim të ndërsjellë mes Autoritetit dhe pushtetit vendor. Ajo theksoi se bashkitë mbartin një rol të veçantë në ruajtjen e kujtesës historike dhe morale të komuniteteve lokale dhe shprehu gatishmërinë për të forcuar bashkëpunimin me Autoritetin.

Pas vlerësimeve për manualin e prezantuar, ajo deklaroi se Bashkia e Pogradecit do të jetë bashkëpunuese edhe në aktivitete të tjera të Autoritetit, duke nënvizuar se, edhe për shkak të pozitës së tij si qytet kufitar, Pogradeci e ka ndjerë më fort mënyrën se si ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

Z. Skënder Vrioni, anëtar i Autoritetit foli për ndryshimet e fundit ligjore në ligjin për dekoratat dhe titujt e nderit, duke theksuar se kriteret për përfitimin e tyre janë forcuar dhe zgjeruar. "Manuali ofron procedura të qarta dhe orientime në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të të përndjekurve politikë, si dhe pasqyron praktika të mira, përfshirë ngritjen e komisioneve këshillimore pranë këshillave bashkiakë; ndaj rekomandohet që të fillojnë procedurat për ndryshimin e emrave të rrugëve dhe datave që i përkasin regjimit komunist, si dhe verifikimi pranë Autoritetit për çdo rast."



"Dialogu me pushtetin vendor është thelbësor, pasi bashkitë kanë përgjegjësinë për emërtimin e shesheve, muzeve dhe hapësirave publike, duke nënvizuar se në vitin 2025 nuk duhet të vendosen emra të dyshimtë që lëndojnë kujtesën dhe familjet që kanë përjetuar persekutimin e regjimit komunist. Ai theksoi se përballja me të kaluarën është një kusht për ndërtimin e një shoqërie më të civilizuar, të hapur dhe pa frikë nga e vërteta." theksoi z. Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit.



Duke paraqitur statistika nga Autoriteti, z. Ioann Çeli, specialisht pranë AIDSSH theksoi një rritje të ndjeshme të kërkesave nga bashkitë gjatë vitit 2024. Përmes shembujve konkretë, z. Celi evidentoi problematikat më të shpeshta në kërkesat e paraqitura dhe dha rekomandime për formulimin e saktë të tyre dhe për procesin e verifikimit paraprak nga ana e bashkive.



Në prezantimin e Manualit për të Zhdukurit, u theksua qasja e unifikuar e bashkëpunimit institucional, rolit kyç të pushtetit vendor në identifikimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist. Në këtë drejtim, anëtar i Autoritetit, z. Hoxha, tha se bashkëpunimi me pushtetin lokal për identifikimin e personave të zhdukur është i rëndësishëm, veçanërisht për zonat kufitare si Pogradeci, Kolonja dhe Korça, për sinjalizimin e rasteve dhe vendndodhjeve të dyshuara, me qëllim rikuperimin e trupave të të zhdukurve gjatë diktaturës. “Nëpërmjet këtyre dialogëve dhe manualeve do të jetë më e lehtë të rritet fryma e mirëkuptimit midis institucioneve që përfaqësojmë.”



Drejtuesja e Drejtorisë për Identifikimin dhe Rikuperimin e trupave të viktimave të komunizmit, znj. Nertila Seitaj, informoi mbi bashkëpunimin ndërinstytucional për mbledhjen e dokumenteve arkivore, intervistat me familjarë dhe dëshmitarë, bashkëpunimin me shoqatat e të përndjekurve politikë, shenjzimin e vendvarrimeve të dyshuara në bashkërendim me bashkitë, si dhe kërkimet jo-invasive në disa lokacione, të realizuara me mbështetjen e ICMP-së dhe ekspertëve ndërkombëtarë.



Nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, Dr. Edlir Orhani theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë të AIDSSH-së me pushtetin vendor në fushën e edukimit qytetar, si një kusht thelbësor për realizimin dhe qëndrueshmërinë e projekteve edukative. Ai vuri në dukje se DMSHEQ është nismëtare e projekteve si “Klubi i Filmit: Mësojmë nga e kaluara”, “Klubi i Filmit” dhe “Klubi i Librit”, të orientuara drejt edukimit të brezit të ri.

Bashkëpunimi me pushtetin lokal, sipas tij, mbështetet në tri shtylla kryesore: arsimin, muzetë dhe objektet e kujtesës, si dhe bibliotekat. Në këtë kuadër, roli i pushtetit vendor është vendimtar në ofrimin e mbështetjes organizative, logjistike dhe financiare, si dhe në promovimin e vendeve të kujtesës, përfshirë guidën dhe dokumentarin për burgun e Spaçit.

Dr. Orhani theksoi se falë këtij bashkëpunimi janë arritur rezultate konkrete dhe të qëndrueshme, përfshirë realizimin e aktiviteteve edukative me nxënësit dhe botimin e librave “Spaçi: Historia e një revolte” dhe “Dielli lind në Spaç”, të cilat kontribuojnë në forcimin e kujtesës historike dhe edukimin qytetar të brezave të rinj.

Në përfundim, nënkryetarja e Bashkisë së Pogradecit, si dhe 14 përfaqësuesit e bashkive të prefekturave Korçë dhe Elbasan, vlerësuan dialogun si një model të frytshëm bashkëpunimi institucional dhe shprehën gatishmërinë për projekte të përbashkëta me Autoritetin në fushën e kujtesës historike, edukimit qytetar dhe promovimit të vlerave demokratike.

Vendimmarrja finale të mbetet kompetencë e pushtetit vendor, në përputhje me kuadrin ligjor po parimisht u diskutua për ngritjen e një komisioni të posaçëm pranë këshillit bashkiak për shqyrtimin e emërtimeve ekzistuese të rrugëve dhe hapësirave publike. Rishikimi i emërtimeve të vendosura në vitet 2010–2011, në funksion të ndjeshmërisë shoqërore dhe historike. Trajtimi rast pas rasti i emërtimeve që lidhen me nomenklaturën komuniste. Mbështetja e vendimmarrjes në verifikimin e figurës pranë Autoritetit.

## HAPJA E DOSJEVE DHE PËRGJEGJËSIA AKADEMIKE, KRYETARJA E AIDSSH LIGJERATË DHE TAKIME NË INSTITUCIONET KËRKIMORE TË KOSOVËS

Prishtinë, 15-16 dhjetor 2025

Në kuadër të një vizite zyrtare në Kosovë, Kryetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Dr. Gentiana Sula, ishte e ftuar për të mbajtur një ligjëratë akademike në Institutin Albanologjik i Prishtinës, e cila u pasua nga takime pune me dy institucione kyçe të kërkimit dhe dokumentimit në Kosovë.

Në qendër të vizitës ishte ligjërata me temën “Hapja e dosjeve dhe përgjegjësia akademike: diktatura, represioni dhe etika e së vërtetës”, mbajtur për publikun akademik dhe studentor të Kosovës. Duke iu referuar reflektimeve të Hannah Arendt mbi shoqëritë totalitare, Dr. Sula theksoi se e vërteta faktike – ajo që dokumentohet dhe verifikohet – mbetet themeli i debatit publik dhe i kulturës akademike, veçanërisht në shoqëri që kanë përjetuar regjime represive.



Në hapjen e sesionit, Prof. Dr. Nuridin Ahmeti, drejtues i Degës së Historisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, vlerësoi rolin e AIDSSH-së si një institucion kyç për ballafaqimin me të kaluarën dhe forcimin e drejtësisë tranzicionale në hapësirën mbarëshqiptare. Drejtuesja e Institutit, znj. Meliza Krasniqi, nënvizoi rëndësinë e dosjeve të ish-Sigurimit si burime të pazëvendësueshme për studimin e fateve individuale dhe kolektive të shqiptarëve në rajon.

Gjatë ligjërates, Kryetarja e Autoritetit u ndal veçanërisht te Fondi dokumentar “Kosova”, me mbi 11.600 fashikuj arkivorë, që dëshmojnë ndjekjen e veprimtarëve politikë kosovarë, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe monitorimin e lëvizjeve studentore e intelektuale, veçanërisht gjatë viteve 1981–1982. Ajo theksoi se hapja e dosjeve nuk është akt publikimi i pakontrolluar, por një proces i strukturuar, i bazuar në ligj, profesionalizëm dhe etikë.



Vizita vijoi me një takim pune në Instituti i Krimeve të Luftës në Kosovë, ku delegacioni i AIDSSH-së u njoh nga afër me proceset e mbledhjes, sistemimit dhe ruajtjes së dokumentacionit që lidhet me krimet e luftës në Kosovë (1998–2000), si dhe me dokumentimin e represionit para luftës. Përfaqësueset e institutit prezantuan punën kërkimore mbi ngjarje si vrasja e ushtarëve shqiptarë në ushtrinë e ish-Jugosllavisë dhe helmimi masiv i nxënësve në vitet 1990–1992, si dëshmi të represionit shtetëror para shpërthimit të luftës.

Në vijim, Dr. Sula zhvilloi një takim zyrtar edhe me drejtuesit dhe studiuesit e Instituti i Historisë Ali Hadri, ku u diskutuan planet për një konferencë të përbashkët shkencore në vitin 2026, kushtuar kufirit Kosovë–Shqipëri si realitet politik dhe njerëzor gjatë periudhës 1944–1991. Drejtoresha e institutit, Prof. Dr. Teuta Shala, shprehu gatishmërinë për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës dhe theksoi rëndësinë e qasjes krahasuese dhe etike ndaj burimeve arkivore.

Në përmbyllje të vizitës, palët vlerësuan se bashkëpunimi ndërmjet AIDSSH-së, Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” synon ndërtimin e një hapësire të përbashkët kërkimore, ku historia trajtohet si proces shkencor dhe arkivat vendosen në shërbim të kujtesës historike, drejtësisë tranzitore dhe të vërtetës publike, me qëllim që shoqëritë tona të mos i përsërisin plagët e së shkuarës.

## **KLUBI I FILMIT “MËSOJMË NGA E KALUARA” DISKUTON FILMIN “VITET E PARA”**

Tiranë, 17 dhjetor 2025

Klubi i Filmit “Mësojmë nga e Kaluara”, në bashkëpunim me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), një nismë edukimi dhe reflektimi mbi kinemanë e periudhës komuniste si produkt i propagandës së regjimit u mbledh për të diskutuar filmi “Vitet e para” (1965), realizuar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, bazuar në romanin “Këneta”, si një vepër tipike e realizmit socialist dhe dëshmi e kohës së vet.





Z. Skënder Vrioni, anëtar i Autoritetit të Dosjeve theksoi rëndësinë e një vështrimi kritik ndaj filmit “Vitet e Para”, duke nënvizuar se ai duhet të lexohet përtej narrativës artistike, si një produkt me ndikim afatgjatë në formimin e brezave të rinj. Sipas tij, filmi duhet të shoqërohet me një histori të plotë dhe të dokumentuar mbi fatin e rreth 2.500 të burgosurve politikë në kampin e Vloçishtit, Maliq, mes tyre figura të njohura si Sami Repishti, Arshi Pipa, Jusuf Vrioni, Vexhi Buharaja, Kujtim Beqiri dhe Abdyl Shara. Ai rikujtoi se në procesin gjyqësor për tharjen e Kënetës së Maliqit, gjykata i shpalli të pandehurit “sabotorë” dhe “armiq të popullit”, duke dënuar me vdekje Vasil Mano, Kujtim Beqiri, Eugenio Scaturro, Abdul Shara dhe Zyrika Mano; me burgim të përjetshëm Mario Guarnieri dhe Pandeli Zograf; me burgime afatgjata Mihal Stratoberdha dhe Anastas Risto; si dhe me një vit burgim me kusht Jani Vasili. Për të dënuarit me pesë vjet burgim e lart u urdhërua konfiskimi i pasurisë, duke e shtrirë ndëshkimin edhe mbi familjet e tyre.”

Drejtori i Arkivit Qendror të Filmit, z. Eljan Tani u shpreh se Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit ruan kujtesën filmike të vendit si një trashëgimi me vlera artistike dhe historike. “Ky cikël aktivitësh synon ta shohë kinemanë me sy kritik. ‘Vitet e para’ përfaqëson një nga aktet më komplekse të kinematografisë shqiptare të periudhës komuniste: një lloj traktati pamor mbi marrëdhënien mes njeriut dhe tokës, ku njeriu shfaqet njëkohësisht si protagonist dhe si vegël e sistemit. Tensioni historik që filmi mbart e ka kthyer atë në një instrument politik, ku gjyqi dhe ndëshkimi vulosin fatin e elitës teknike dhe intelektuale. Ky dualitet – histori e shpallur suksesi dhe njëkohësisht histori persekutimi – e bën filmin njëkohësisht propagandë dhe vepër arti. Mjeshtëria filmike, balta e Maliqit, loja e dritës dhe hijes nuk janë boshllëqe të kohës, por elemente që sot na lejojnë ta rilexojmë këtë

vepër si një udhëkryq mes mitit të njeriut që mposht natyrën dhe realitetit të shtetit totalitar. Pikërisht këtë synon të sjellë ky debat: një përballje të ndershme mes artit, propagandës dhe historisë.”

Moderatorja e këtij eventi, Rovena Rozhani, specialiste e edukimit qytetar pranë AIDSSH, përmes punimit të saj mbi historinë e filmit “Vitet e para”, solli për audiencën një qasje aktive dhe të argumentuar, duke ndërthurur dokumente arkivore të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit nga AIDSSH, si dhe dëshmi të fëmijëve të inxhinierëve të vvarë dhe të familjeve të tyre të përndjekura.

Për audiencën e zgjedhur, të përbërë nga profesorë, studiues të historisë, mësues dhe studentë të historisë, si edhe juristë të ardhshëm, erdhi i plotë edhe studimi i Prof. As. Dr. Sonila Boçi, “Fajtorë pafaj: gjyqi kundërinxhinierëve të Kënetës së Maliqit”: “Publiku shqiptar është prej vitesh i përfshirë në debatin mbi mënyrën se si duhet trajtuar kinematografia dhe teatri i prodhuar gjatë regjimit komunist: mes kërkesave për censurë dhe nevojës për përballje kritike. Në regjimet totalitare, pro-



paganda ishte një armë po aq e fuqishme sa dhuna, ndërsa kinematografia u përdor për të ndërtuar një realitet të rremë, për të stigmatizuar “armikun e popullit” dhe për të justifikuar dështimet e pushtetit. Filmi “Vitet e para”, i bazuar në romanin “Këneta”, është një shembull i qartë i këtij mekanizmi: një narrativë propagandistike që glorifikon pushtetin dhe fajëson specialistët e projektit të Maliqit për dështime strukturore, duke fshehur realitetin e persekutimit, shfrytëzimit të të burgosurve politikë dhe mungesës së kushteve teknike. Sot, falë dokumenteve arkivore dhe dëshmime reale, kemi mundësinë të dallojmë propagandën nga e vërteta historike. Censura nuk është zgjidhje; përkundrazi, shfaqja e këtyre veprave e shoqëruar me analizë kritike, fakte dhe kontekst historik është mënyra më e përgjegjshme për të ndërtuar ndërgjegjësim, për të nderuar viktimat dhe për të forcuar vlerat e demokracisë, mendimin kritik dhe kulturën e kujtesës.”

Dr. Anxhela Çikopano, studiuese e teatrit pranë Qendrës së Studimit të Arteve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, i parashtrori këto qëndrime në punimin e saj “E përdala dhe shenjtoria: gruaja në filmin ‘Vitet e para.’” Kinematografia e realizmit socialist shpesh u përdor nga pushteti komunist si mjet për të përligjur

gënjeshtërën dhe dhunën e tij. Pyetja thelbësore nuk është nëse këta filma duhen parë apo jo, por si duhen parë. Në “Vitet e para”, kinemaja përqafton qartësisht një logjikë patriarkale dhe ideologjike, ku gratë vendosen në dikotominë “shenjtore/kurvë”, një formulë e njohur për ndarjen morale të shoqërisë. Personazhet femërore shenjtërohen vetëm nëse përqafojnë revolucionin dhe flijojnë veten për rendin e ri, ndërsa seksualiteti i lirë dhe mosbindja ndëshkohen simbolikisht dhe fizikisht. Fati i Zyrakës, i lidhur vizualisht me ekzekutimet reale të Maliqit, e shndërron filmin në një instrument propagandistik që legjitimon eliminimin e “armikut” përmes gjuhës së artit. Kështu, “Vitet e para” mbetet një shembull i qartë se si kinemaja u përdor për të ndërtuar mite, për të justifikuar krimin dhe për të deformuar kujtesën historike.

Sipas doktorantes Kejsi ZIU, juriste dhe drejtuese projekti pranë Këshillit të Evropës, me ekspertizë në drejtësinë tranzitore dhe sundimin e ligjit, e cila ka marrë në studim shkëlqen e të drejtave të njeriut përmes rastit të gjyqit të inxhinierëve të Maliqit dhe simbolikës së shprehur në filmin “Vitet e para”: “Një shoqëri demokratike funksionon vetëm kur ligji qëndron mbi politikën dhe drejtësia është e pavarur, e bazuar në prova dhe jo në ideologji. Asnjë interes shtetëror nuk mund të justifikojë shkëlqen e të drejtave themelore të njeriut, torturën apo ekzekutimet pa gjyq. Regjimet autoritare përdorin artin dhe kinemanë si mjete propagande për të deformuar realitetin dhe për të ndarë shoqërinë në ‘të mirë’ dhe ‘armiç’. Prandaj, sot është thelbësore që këto vepra të lexohen kritikisht, të shoqëruara me fakte dhe dokumente, në mënyrë që demokracia të mbështetet në institucione të forta, liri shprehjeje dhe qytetarë.”

A duhej tharë kënetat? Kësaj pyetje iu përgjigj urbanistja, Dr. Dorina Pojani, e cila tha se: Rasti i kënetës së Maliqit tregon se si ideologjia socialiste e paraqiti natyrën si armik që duhej nënshtruar në emër të progresit. Përmes letërsisë dhe filmit, një projekt ekologjikisht i dëmshëm dhe njerëzisht kriminal u mitizua si fitore e shkencës dhe e Njeriut të Ri. Në këtë narrativë, puna e detyruar e të burgosurve politikë dhe dhuna ndaj grave u zhdukën ose u deformuan qëllimisht. Ironikisht, sot zona përballet sërish me përmbajtje dhe kriza mjedisore, duke zbuluar dështimin e këtij vizioni linear të zhvillimit.”



Agron Sharra, nipi i inxhinierit të pushkatuar pa faj Andyl Sharra, u shpreh se: “Nuk e kam parë filmin në kohën kur u shfaq, por brenda familjes sonë ne e njihim shumë mirë atë histori. Për ne, filmi ishte pjesë e një realiteti të dhimbshëm që e dinim se nuk përputhej me të vërtetën. Sot është e domosdoshme të vendoset një raport i ndershëm mes historisë reale dhe mënyrës se si ajo është deformuar nga propaganda. Arti i realizmit socialist, i parë edhe nga këndvështrimi juridik, duhet të shoqërohet me një shpjegim dhe referencë historike për publikun, në mënyrë që audiencia dhe veçanërisht të rinjtë të kuptojnë kontekstin e vërtetë të ngjarjeve dhe të jenë në gjendje t’i vlerësojnë këto vepra me mendim kritik. Ende nuk ka një qëndrim zyrtar apo një kërkim-falje për atë që ka ndodhur, dhe është në nderin e këtij institucioni që ta trajtojë këtë çështje me ndershmëri. Kur më vonë erdhën ekspertë rusë për të vijuar projektin e tharjes së kënetës, ata kërkuan të sillleshin inxhinierët shqiptarë. Kur u tha se ata ishin ekzekutuar, përgjigja ishte: ‘Vazhdoni projektin sipas atij plani’. Kënetë u tha pikërisht ashtu siç kishin parashikuar inxhinierët tanë. Ata ishin personalitete të kohës, profesionistë që kanë ndërtuar ura dhe vepra që qëndrojnë ende sot.” Përgjegjësja e edukimit, Brunilda Çërraga, nënvizoi se trajtimi i filmave të realizmit socialist duhet të shërbejë si mjet edukimi qytetar, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë dallimin mes propagandës dhe realitetit historik, duke nxitur mendimin kritik dhe respektin për të vërtetën historike, veçanërisht në kontekstin e një shoqërie demokratike. Klubi i filmit u mbyll me pyetjen e ngritur nga moderatorja e takimit, Rovenë Rozhani – “A do të kemi film të ri për historinë e errët të tharjes së Kënetës së Maliqit?”, një pyetje që fton të pranishmit që të reflektojmë jo vetëm mbi nevojën

e një rrëfim të ri artistik, por mbi përgjegjësinë për ta treguar historinë me ndershmëri, fakte dhe respekt për viktimat, duke e çliruar artin nga propaganda, shpifja, denigrimi njerëzor dhe duke ia kthyer atë së vërtetës. Historia e vërtetë e tharjes së Kënetës së Maliqit ndërthur të gjithë elementët e dhunës së një regjimi diktatorial: burgosjen politike të elitës, punën e detyruar, torturat, zhdukjen e trupave, dënimin me vdekje të inxhinierëve, ndëshkimin fizik dhe moral të grave, deri te vrasja e foshnjës. Kjo histori që kërkon të rrëfëhet me fakte, ndershmëri dhe respekt për viktimat.



